



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 628/112 Prot.

Tiranë, më 23.04.2021

VENDIM

Nr. 70 Date 23.04.2021

PËR

HAPJEN E PROCESIT PËR APLIKIM TË KANDIDATËVE TË KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARTEVE TË CILËSISË, BOTIMEVE DHE PROJEKTEVE SHKENCORE, KOMISIONIT TË KURRIKULAVE SI DHE KOMISIONIT TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

Në zbatim të neneve 38 (pika 1, germa "i"), 46 (pika 3) të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH", të neneve 20 (germa "n"), 26 të Statutit të UST-së, në nenin 10 të Rregullores së UST-së, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e dates 23.04.2021

Vendosi:

1. Fillimin e procesit për rregjistrimin e kandidatëve për ngritjen e :
 - Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore;
 - Komisionit të Kurrikulave;
 - Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe të Marrëdhënieve me Studentët;
2. Rregjistrimi të bëhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së nga data 27.04.2021 - 30.04.2021.
3. Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.
4. Sekretaria e Senatit Akademik të përpilojë "Njoftim" për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësisë kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

REKTOR

